



RTK 1
Mentor SHALA
Drejtor
Prishtinë

Rasti Nr. 2018/2
Ref:1807/798/KPM/mf

VENDIM

Lidhur me Rastin Nr. 2018/2 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për RTK 1 (“Pala Përgjegjëse”)

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Kodin e Etikës për Ofriuesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovë KKPM-2016/3, i cili ka hyrë në fuqi më 11 tetor 2016. Me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 janë përcaktuar rregullat e sjelljes dhe të punës së shërbimeve mediale audiovizuale në pajtim me dispozitat ligjore që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike.
2. KPM me datën 7 shkurt 2018 ka pranuar një ankesë nga ASHNA ndaj një kronike të transmetuar me datën 2 shkurt 2018, në edicionin e lajmeve të orës 19:30 të Palës Përgjegjëse, në të cilën janë trajtuar problemet e sigurisë në Aeroportin e Prishtinës. ASHNA ka bërë ankesë me pretendimin se: “*RTK 1 nuk ka kërkuar përgjigje nga ASHNA lidhur me çështjet e trajtuar në kronikë dhe as nuk ka pranuar ndonjë kërkesë nga RTK 1 përmes telefonit apo e-mailit zyrtar...*”
3. KPM me datën 8 shkurt 2018 përmes një shkresë e ka njoftuar Palën Përgjegjëse për ankesën e pranuar nga ASHNA dhe ka kërkuar që brenda tre ditësh të sjellë sqarim lidhur me ankesën në fjalë.
4. KPM brenda afatit të përcaktuar nuk ka pranuar asnjë përgjigje nga Pala Përgjegjëse lidhur me kërkesën e KPM-së.
5. KPM ka analizuar ankesën e ASHNA, e ka monitoruar kronikën e lartpërmendur dhe në bazë të Raportit të monitorimit të datës 14 shkurt 2018 ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03.
6. KPM pas të gjeturave nga Raporti i monitorimit, me datën 23 shkurt 2018 i ka dërguar Palës Përgjegjëse Njoftim për Shkelje me të cilin e ka njoftuar për shkeljet e bëra dhe i ka

kërkuar të veprojë në pajtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03, duke i ofruar ASHNA-së të drejtën e demantit në mënyrë të plotë në afat prej shtatë (7) ditësh.

7. KPM me datën 26 shkurt 2018, pas kalimit të afatit, ka pranuar një përgjigje nga Pala Përgjegjëse në lidhje me kërkesën e Zyrës Ekzekutive për sqarim. Sipas Palës Përgjegjëse kronika është bazuar tërësisht në raportin zyrtar të EULEX-it dhe se kanë tentuar disa herë t'i kontaktojnë zyrtarët e ASHNA-së, por ata nuk janë përgjigjur, gjë që e kanë përmendur edhe në kronikën e transmetuar. Në përgjigje pohohet se ata e kanë transmetuar reagimin e ASHNA-së në lajmet e orës 23:00. Po ashtu, sipas tyre drejtori i ASHNA-së Bahri Nuredini ka biseduar pastaj me redaktoren Blerta Foniqi Kabashi, i cili ka deklaruar se i mjafton publikimi i reagimit të tyre në lajmet e orës 23:00 dhe se ishte ftuar nga redaktorja të shkojë si mysafir i veçantë të nesërmen në lajmet qendrore për të diskutuar për raportin në fjalë, mirëpo ai kishte refuzuar.

Analiza Ligjore

8. Komisioni bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton Pala Përgjegjëse është gjetur në shkelje të nenit 6, paragrafi 2 dhe nenit 10, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

Neni 6, paragrafi 2, i Kodit të Etikës KKPM-2016/03 përcakton se:

"OSHM-të duhet të sigurojnë një mbulim të balancuar të çështjeve me interes publik dhe çështjeve të kundërthënieve politike dhe të sigurojnë një paraqitje pluralistike të pikëpamjeve, pa asnjë privilegi për ndonjë parti politike, këndvështrim politik apo ndonjë grup ose individ."

Komisioni në bazë të monitorimit të kronikës së transmetuar ka gjetur se nuk është siguruar mbulim i balancuar dhe paraqitje pluraliste e pikëpamjeve. Kronika është bazuar vetëm në një raport të EULEX-it dhe nuk janë dhënë pikëpamje nga palët tjera të përmendura në kronikë, si ASHNA dhe organet mbikëqyrëse të saj, organet kompetente të sigurisë ajrore apo KFOR-it, me qëllim të ofrimit të sqarimeve për publikun rreth çështjeve të sigurisë në Aeroportin e Prishtinës dhe çështjeve tjera të ngritura në këtë kronikë.

Nenin 10, paragrafi 1 i Kodit të Etikës KKPM-2016/03 përcakton se:

"Me qëllim të korrektësisë dhe paanshmërisë duhet të ofrohet mundësia që brenda shtatë (7) ditësh pas paraqitjes së ankesës së individit apo organizatës, të transmetohet reagimi përkatës në mediumin e njëjtë. Reagimi duhet të transmetohet në kohë dhe hapësirë të njëjtë."

Komisioni në bazë të monitorimit të kronikës ka gjetur se Pala Përgjegjëse nuk e ka transmetuar të plotë reagimin e ASHNA, duke mos i ofruar hapësirë të njëjtë dhe nën kushte të njashme që t'i mundësojë sqarimet për të gjitha çështjet e përmendura në kronikë. Edhe përkundër faktit së në kronikën e saj është theksuar se Kulla e Aeroportit mund të merret në kontroll nga KFOR-i për shkaqe sigurie, nuk e ka transmetuar fare pjesën e reagimit ku përfshihej KFOR-i, përmes të cilit ky i fundit e mohon një mundësi të tillë.

- Komisioni ka gjetur se Pala Përgjegjëse edhe pas Njoftimit për shkelje të dërguar nga KPM në të cilin i është kërkuar që t'i ofrojë ASHNA-së të drejtën e demantit në mënyrë të plotë në afat prej shtatë (7) ditësh, Pala Përgjegjëse ka dështuar ta bëjë, duke pohuar në përgjigjen e tyre se ia kanë dhënë të drejtën e demantit ASHNA-së po atë ditë.
- Komisioni duke u bazuar në faktet e lartpërmendura ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 6, paragrafi 2 dhe nenit 10 paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

Vendimi

- Komisioni bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 6, paragrafi 2 dhe nenit 10, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.
- Komisioni bazuar në nenin 30 paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, merr vendim që Pala Përgjegjëse të sanksionohet me **Vërejtje**, për shkelje të nenit 6, paragrafi 2 dhe nenit 10, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.


E drejta për Ankesë

- Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
- Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërisht relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.



 Muja PERATI
 Kryetar




 Datë